



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura-III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, më 08 prill 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Mimoza Ahmetaj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Armend Zemaj, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq, Teuta Hadri dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Drita Morina - zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta - nëpunëse administrative;

Nga Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB): Agim Shahini dhe Albert Maloku;

Nga Handikos: Halit Ferizi;

Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri;

Nga NDI: Shefki Kastrati;

Nga KDI: Fitore Zeneli.

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit
Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara
4. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara
5. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa plotësime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryetari - Tha se Komisioni i ka pasur disa dilema lidhur me Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Për ta evituar çdo dilemë Komisioni e ka konsideruar të nevojshme, të dëgjohej përfaqësuesit e AKB-së dhe përfaqësuesit e HANDIKOS-it. Ai tha se propozuesit e amendamenteve për këtë Projektligj janë takuar si grup pune. Gjithashtu janë disa propozimamendamente të deputetes Qamile Morina, që nëse miratohen nga Komisioni, kalojnë si amendamente të Komisionit Funkcional. Ai e ftoi kryesuesen e grupit të punës, deputeten Flora Brovina, t'i paraqesë këto propozime.

Flora Brovina - Tha se, në përgjithësi, grupi i punës ka arritur t'i harmonizojë propozimamendamentet, përveç një amendamenti të propozuar nga deputetja Teuta Hadri, për të cilin grupi i punës ka konsideruar se ka implikime buxhetore. Ndërsa, sa i përket propozimeve nga deputetja Qamile Morina, grupi i punës nuk ka mundur të vendosë, meqë këto propozime nuk kanë qenë të shkruara në formë elektronike. Ajo para Komisionit i propozoi amendamentet e dala nga grupi i punës.

Amendamentet e pranuar në parim, për të cilat Komisioni do të votojë në fund të shqyrtimit të këtij Projektligji, janë: amendamentet 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 13, 14, 15, 16, 18, 19, 20, ndërsa, për amendamentet 3, 5, 11, 12, 17, pati diskutime nga anëtarët e Komisionit, nga përfaqësuesit e AKB-së dhe nga përfaqësuesit e HANDIKOS-it.

Amendamenti 3

Titulli i Projektligjit riformulohet:

“Projektligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara”

Gjylnaze Sylja - Propozoi të shtohet një nen i ri, që fjala “rehabilitim” të zëvendësohet me fjalën “riaftësim” në tërë tekstin e Projektligjit, me qëllim të harmonizimit me titullin e Projektligjit.

Flora Brovina - Tha se ajo që propozoi deputetja Gjylnaze Sylja është vështirë të arrihet pasi gjithëherë nuk mund ta përdorim fjalën riaftësim, meqë kjo varet nga fjalia.

Amendamenti 5

Në nenin 3, paragrafi 2, riformulohet:

“Person me aftësi të kufizuara për punë, është ai me aftësi të kufizuara, aftësia e të cilit në raport me aftësinë e personit që nuk ka aftësi të kufizuara të moshës së njëjtë ose të përafërta, me edukim të njëjtë ose të përafërt, me kushte të njëjta të punës ose të përafërta, në punë të njëjta, ose të përafërta e që si pasojë e ka aftësinë e përhershme të kufizuar, ose së paku 12 muaj mundësinë e kufizuar për

aftësinë e zvogëluar të punës, që të punësohet dhe të konkurrojë në tregun e punës, me kushte të përgjithshme dhe të barabarta”.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit për diskutim lidhur me amendamentin 5

Gjylnaze Syla - Tha se lidhur me nenin 3, paragrafi i parë dhe i dyti, i ka dy vërejtje. Në paragrafin e parë propozoi të bëhet harmonizimi i termave me Projektligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara. Për propozimin që e ka dhënë grupi i punës lidhur me nenin 3, paragrafi 2, ajo mendon se është i gjatë. Propozoi një riformulim, në mënyrë që ky nen të jetë më i qartë: *“Person me aftësi të kufizuara për punë, është personi me aftësi të kufizuara, aftësia e të cilit në raport me aftësinë e personit që nuk ka aftësi të kufizuara të moshës së njëjtë ose të përafërta, me edukim të njëjtë ose të përafërt, me kushte të njëjta të punës ose të përafërta, në punë të njëjta ose të përafërta, ka si pasojë aftësinë e përhershme të kufizuar, ose së paku 12 muaj për aftësinë e zvogëluar të punës, mundësinë e kufizuar që të punësohet dhe të konkurrojë në tregun e punës, me kushte të përgjithshme dhe të barabarta”*.

Halit Ferizi - Tha se amendamenti i propozuar nga grupi i punës lidhur me nenin 3, paragrafi 2, duhet të mbetet i tillë. Ai propozoi që i vetmi ndryshim në këtë amendament të jetë zëvendësimi i togefjalëshit: *“Mundësinë e kufizuar”* me tekstin: *“mundësinë e zvogëluar për aftësim, mundësinë e zvogëluar të punësohet dhe të punojë në tregun e punës me kushte të përgjithshme dhe të barabarta”*.

Kryetari konstatoi se anëtarët e Komisionit u pajtuan që ky amendament i propozuar nga grupi i punës të pranohet me ndryshimet e propozuara sipas riformulimit të z. Halit Ferizi.

Amendamenti 11

Në nenin 3, pas paragrafit 14, shtohet një paragraf i ri – 15, me këtë përmbajtje:

“Asistenti është person i domosdoshëm pa të cilin personi me aftësi të kufizuara nuk mund të aftësohet, të riaftësohet për punë ose të krijojë marrëdhënie pune”.

Halit Ferizi - Lidhur me amendamentin 11 pati vërejtje se jo të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për asistent. Ai propozoi që kjo të mbetet për persona të caktuar.

Amendamenti 12

Në nenin 3, pas paragrafi 21, shtohet paragrafi i ri 22, me këtë përmbajtje:

“Qendra Koordinuese është qendër ndërlidhëse ndërmjet MSH, MPMS, QAP, QRPK, QRP dhe ZKP. Kjo qendër drejtpërdrejt i përgjigjet Qeverisë”.

Flora Brovina - Tha se propozimamendamenti 12 nuk e ka përkrahjen e grupit të punës, sepse ka të bëjë me themelimin e Qendrës Koordinuese, që pastaj sjell implikime buxhetore. Ky amendament propozohet si amendament i deputetes Teuta Hadri. Sipas saj kjo çështje duhet të mbetet si në Ligj.

Rita Hajzeraj - Tha nëse Komisioni e përkrah këtë propozimamendament, atëherë implikimet buxhetore do të jenë të mëdha.

Armend Zemaj - Ishte i mendimit se e gjithë kjo i komplikon situatën dhe përgjegjësinë e Ministrisë dhe të qendrave të rehabilitimit. Ai propozoi që ky amendament të mos kalojë.

Halit Ferizi - Tha se kjo çështje është shpjeguar në nenin 3, pika 14.

Gjylnaze Syla - Ishte e mendimit se ky propozimamendament nuk duhet të përkrahet, me arsyetimin se po e ndërlikon më shumë zbatimin e Ligjit. Ajo tha se neni 29 flet për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë që e bën Ministria. Pra kjo është përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit të votojnë për këtë propozim dhe konstatoi se nuk kaloi propozimamendamenti i Teuta Hadrit.

Amendamenti 14

Neni 4, paragrafi 4, riformulohet:

“Nxënësi prej moshës 7-18, me aftësi të kufizuara mendore, fizike psikike ose të kombinuara, sipas dispozitave ligjore të aplikueshme për shkollim e arsimim, duke ua siguruar atyre që kanë nevojë edhe për gjuhën e shenjave për personin e shurdhër dhe alfabetin e Brajtit për të verbrit”.

Kryetari – Për amendamentin 14, tha se duhet të përkrahet, por me ndryshimin që te përcaktimi i moshës, të hiqet mosha “7-18” dhe të zëvendësohet me “15-18”.

Mimoza Ahmetaj - Ishte e mendimit se nëse insistohet që kësaj kategorie t`i mundësohet mësimi i alfabetit të Brajtit, atëherë në kuadër të këtij Ligji të shtohet edhe një pikë, në mënyrë që fëmijëve nga mosha shtatë (7) -vjeçare t`u mundësohet ta mësojnë alfabetin.

Kryetari - Tha se duhet të kihet parasysh se ky Komision është duke e shqyrtuar Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe kjo çështje të rregullohet me Ligjin për arsimimin e këtyre personave.

Qamile Morina - Tha se ka një propozim tjetër nga a ai që e ka propozuar grupi i punës për nenin 6, paragrafi 2. Sipas propozimit të saj ky paragraf riformulohet si vijon: *“Komisionin e ekspertizës e emëron ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me propozim të Qendrës për Rehabilitim dhe Aftësim Profesional që përbëhet nga pesë (5) anëtarë: kryetari - mjek-specialist i punës, një anëtar me edukim të lartë të psikologjisë, sociologjisë, pedagogjisë apo sociale; një anëtar – ekspert nga lëmi i punësimit me edukim të lartë, një anëtar – ekspert nga lëmi specifik, varësisht nga të metat trupore dhe një anëtar i zgjedhur nga shoqata e personave me aftësi të kufizuara. Këtë propozim e ka bërë me qëllim që të qartësohet se vlerësimin e këtyre personave do ta bëjë Komisioni me këtë përbërje profesionale. Gjithashtu propozoi që në nenin 6, pas paragrafit 2, të shtohet një paragraf i ri me këtë formulim: “Komisioni e bën vlerësimin e mundësive të punësimit në bazë të vlerësimeve mujore dhe evaluimit përfundimtar të Qendrës për Rehabilitim Punësim dhe Aftësim”.*

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me propozimin e deputetes Qamile Morina.

Armend Zemaj - Tha se përbërja e Komisionit të ekspertizës është sqaruar në nenin 3. Ai ishte i mendimit se nëse në këtë Komision të ekspertizës janë përfshirë ekspertë mjekësorë, nuk ka nevojë të përcaktohen ata. Propozon që kjo çështje të mbetet si ka qenë në Ligj.

Gjylnaze Syla - Tha se në nenin 14 është specifikuar që Qendrën për Riaftësim Profesional dhe Punësim e formon MPMS dhe përgjegjësit e saj i përcakton me akt nënligjor.

Armend Zemaj - Tha se neni 14 në të gjitha pikat hollësisht e përcakton funksionimin e Qendrës për Riaftësim Profesional dhe Punësim.

Rita Hajzeraj - Tha se Komisioni i ekspertizës që e emëron Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale me një vendim të veçantë, do të përbehet jo vetëm nga një komision mjekësor por edhe prej anëtarëve të tjerë.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit të votojnë për propozimamendamentin e deputetes Qamile Morina.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash refuzohet ky propozim.

Qamile Morina - Propozoi që në nenin 7, paragrafi 3, në rreshtin e tretë pas fjalës: “*të drejtës*”, të shtohet fjala: “*për punë*” dhe teksti të vazhdojë si në Projektligj. Pati edhe një propozimamendament për nenin 8, paragrafi 1, në rreshtin e katërt, fjala: “*të peshës*”, të zëvendësohet me fjalën: “*të shkollës*”.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që amendamentet e propozuara nga deputetja Qamile Morina të pranohen në parim dhe për to të votohet në fund të shqyrtimit të të gjitha propozimeve.

Kryetari i falënderoi përfaqësuesit e AKB-së për pjesëmarrje dhe i ftoi për t’i shprehur qëndrimet e tyre lidhur me Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Agim Shahini - Përfaqësues i Aleancës për Biznes të Kosovës tha se me nenin 12 çdo punëdhënës që i ka punësuar më tepër se 24 punëtorë, është i detyruar ta punësojë një person me aftësi të kufizuara. Ekonomia e tregut e Kosovës është e fokusuar në tregun e hapur. Ai tha se në tregun e punës nuk ka obligime të tjera, përpos obligimit për taksa. Pastaj investitorët e huaj, nëse do ta vërejnë një obligim të tillë, atëherë do të ngurrojnë të investojnë pikërisht për këtë obligim. Propozimi i tij ishte që punëdhënësi të mos obligohet, por të jetë kjo si mundësi, numri të mos kufizohet, por dhe të zgjatet afati i përcaktuar me nenin 17.

Halit Ferizi - Tha se nëse propozimet e paraqitura në nenin 12 të këtij Projektligji nuk merren për bazë, atëherë i gjithë Ligji nuk ka kurrfarë efekti.

Armend Zemaj - Tha se obligimi i paraparë me nenin 12 nuk është brengosës, por për mendimin e tij brengosës është kufizimi i numrit të paraparë me këtë Projektligj. Numri i përcaktuar që çdo i 25-ti punëtor të jetë person me aftësi të kufizuara, nuk ka nevojë të përcaktohet. Për personat që nuk kanë aftësi të konkurrojnë në tregun e hapur, janë qendrat që merren me rehabilitimin e tyre. Prandaj, në tregun e hapur të gjithë ata persona do të konkurrojnë në mënyrë të barabartë.

Qamile Morina - Tha se Komisioni i ekspertizës duhet të jetë ai që gjatë kohës së rehabilitimit do ta bëjë vlerësimin se cilët janë ata persona që mund ta kryejnë 1/3 –tën e punës të një njeriu të rëndomtë dhe këta do të jenë persona të përcaktuar si të aftë për punë në ambient normal, kurse të tjerët do të hyjnë në kategori tjetër, për të cilët janë punëtoritë e posaçme. Sa i përket numrit të përcaktuar 25, tha se mund të mendojmë edhe për kuotë.

Gjynaze Sylja - Ishte e mendimit se duhet të konsultohen ekspertë ligjorë për këtë çështje. Personalisht tha se në këtë nen do të jetë e detyruar të abstenojë, sepse nuk është e bindur se cila zgjidhje është më e mirë.

Nurishahe Hulaj - Tha se edhe në mandatin e kaluar, varësisht nga situata, kemi angazhuar ekspertë ligjorë . Ishte e mendimit që në Ligj duhet të jetë i definuar numri, siç është rasti këtu, çdo i 25 –ti punëtor, të jetë person me aftësi të kufizuara.

Kryetari - Tha se mbledhja do të vazhdojë në javën e ardhshme me propozimet tuaja për këtë nen.

Mbledhja e radhës do të mbahet të martën e ardhshme më 15. 04. 2008, ora 11:00

Përgatitur nga
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz